

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 11, datë 15/ 04/ 2019**

**MBI**

**“MIRATIMIN PARAPRAK, PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT  
FOTOGRAFI, CIKLI I PARË BACHELOR, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË  
BUKURA TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 14, datë 09.04.2019 “Mbi Miratimin paraprak, për hapjen e programit të studimit Fotografi, cikli i parë Bachelor, në Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve”; Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë” dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Fakulteti i Arteve të Bukura, pasi e diskutoi me votim të hapur,

**VENDOSI:**

1. Miratimin paraprak, për hapjen e programit të studimit Fotografi, cikli i parë Bachelor, në Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit së Arsimit Sportit dhe Rinisë për miratim përfundimtar.
3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof. Besnik BISHA (Kryetar)**

**Risena XHAJA (Anëtar)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

**Prof. Arben BASHA (Anëtar)**

\_\_\_\_\_

**Aida MARTIRO (Anëtar)**

\_\_\_\_\_

**Prof. Artan PEQINI (Anëtar)**

\_\_\_\_\_

**Prof. Bujar KAPEXHIU (Anëtar)**

\_\_\_\_\_

**Lorenc VANGJELI (Anëtar)**

\_\_\_\_\_



UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEKANI

Nr. 1 prot.

Tiranë, më 11/1 2019

**Lënda:** Parashikim kostosh financiare për riorganizimin e 7 programeve në Ciklin e Parë të Studimeve -Bachelor si dhe hapjen e programit të ri "Fotografi" në Ciklin e Parë të Studimeve -Bachelor

**Drejtuar:** Rektorit të UART, Prof. Kastriot Çausi  
Administratorit të UART, Zj. Alma Sinani

Bazuar në kërkesën e parashtruar për Hapjen e Programit të ri "Fotografi" në ciklin e Parë të Studimeve – Bachelor si dhe në Urdhërin me nr.1, dt. 11.01.2019 për Riorganizimin e 7 (shtatë) programeve në Ciklin e Parë Bachelor ju bëjmë me dije dhe të parashikoni koston financiare të këtyre ndryshimeve pranë Fakultetit të Arteve të Bukura

Bashkëngjitur do të gjeni Urdhërin nr.1, dt. 11.01.2019 mbi "Riorganizimin e programeve Pikturë dhe Skulpturë në Ciklin e Parë të Studimeve" si dhe kërkesën me nr.132 prot. dt. 05.12.2018 për hapjen e programit të ri "Fotografi".

PROF. ASOC. ARDIAN ISUFI

DEKAN

FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEKANI**

**U R D H Ë R**

**Nr. 1, Datë 11.01.2019**

**PËR**

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TE STUDIMIT PIKTURË DHE SKULPTURË  
NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR**

Bazuar ne ligjin Nr. 80/2015 ( neni 35 ) për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë , në Udhëzimin nr. 31 dt. 29.12.2017 i MARS për për hapjen dhe/ose organizimin e programeve të studimit.

**URDHËROJ:**

1. Riorganizimin e programeve të studimit Pikturë dhe Skulpturë në Ciklin e Parë Bachelor në:

Pikturë Kavaleti, Pikturë Monumentale si pjesë të strukture së Njesisë Bazë Pikturë, Pikturë Multimedia, Pikturë Grafikë, Pikturë Tekstil dhe Modë si pjesë e së Njesisë Bazë të Arteve të Aplikuara dhe Skulpturë, Skulpturë Qeramike si pjesë e strukturës së Njesisë Bazë Skulpturë.

2. Dosja e përgatitur për këto programe të kalohet në Senatin e Universitetit të Arteve për miratim.

**PROF. ASOC. ARDIAN ISUFI**

**DEKAN**

**FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEKANI**

Nr. 132 . prot.

Tiranë, më 05.12.2018

**Drejtuar : Rektorit të UART, Prof. Kastriot ÇAUSHI**

**Lënda:** Parashtrim kërkesë për hapjen e programit të ri “FOTOGRAFI”

**KËRKESË**

***I Nderuar z. Rektor,***

Në kuadër të pasurimit të FAB me programe gjithmonë e më shumë pranë nevojave të tregut dhe duke u bazuar në eksperiencën personale të mësimdhënies si dhe në testime të ndryshme ndër studentë të FAB, nxënës të shkollës së mesme artistike “Jordan Misja”, por edhe me artistë, personalitete të mendimit dhe të artit, individë pasionante të artit të fotografisë por edhe me maturantë që kanë dëshirën të studiojnë për fotografinë dhe nuk e shohin diku këtë mundësi përveç se jashtë Shqipërisë, shikoj të arsyeshme, imediate dhe mjaft të nevojshme krijimin e programit të studimit “FOTOGRAFI” në Ciklin e Pare Bachelor në Departamentin e Arteve të Aplikuara në FAB.

Emërtimi i programit të studimit: FOTOGRAFI.

Njesia bazë : DEPARTAMENTI I ARTEVE TË APLIKUARA.

Cikli i studimit : BACHELOR .

Lloji i programit të studimit: Me kohë të plote

Kodi i programit: AB1FOTO

Kreditet e fituara: 180 ETC

Gjuha e studimit: SHQIP.

**PROF. ASOC. ARDIAN ISUFI**

**DEKAN**

**FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**